



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 21.09.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE

1. **MIRATOHET** Vendimi për transferimin e mjeteve nga kategoria e subvencioneve të Administratës në kategorinë e subvencioneve të Drejtorisë së Arsimit.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, nga kategoria e subvencioneve të Administratës, mjetet në vlerë prej 120,000.00 € (njëqind e njëzet mijë euro), transferohen në kategorinë e subvencioneve të Drejtorisë së Arsimit.
3. Sipas pikës 2 të këtij vendimi, transferimi i mjeteve, në vlerë prej 120,000.00 €, bëhet me qëllim të subvencionimit të çerdheve me bazë në komunitet, për realizimin e pagesave të dy çerdheve për muajin korrik, si dhe të gjitha çerdheve për muajt gusht - dhjetor 2022.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/01-206970/22 më, 26.09.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

